



Data: 08.08.2017

Ref.: 659/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.585/17, datë 21.07.2017 e BPrAL e Kolegjit Universum për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.589/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.589/17, datë 06.07.2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji Universum me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 589/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegjit Universum nuk u janë akredituar programet e studimit: Shkenca Kompjuterike, MSc. 120 ECTS; Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS, dhe Infermieri - Mami (Ferizaj), BA, 180 ECTS.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji Universum, KSHC ka konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka sjellë dëshmi mbi bazën e të cilës do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të aplikacionit të Kolegjit Universum është trajtuar me saktësi maksimale nga AKA.

Vendimi i KSHC për mos riakreditim të programeve të studimit të BPrAL Kolegjit Universum, është në përputhje të plotë me nenin 22, pika 2 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (UA nr.20/2016, datë 20.09.2016) ku thuhet: "Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve, KSHC do të vendos për akreditim ose mos akreditim". Andaj, bazuar në dispozitat e cekura më lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Universum;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

